

UDHËZIM
Nr. 8, datë 16.3.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 32, DATË 23.12.2022, “PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE DHE TË MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2023”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 26 dhe 51, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 7 dhe nenit 8, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJMË:

1. Pika 15, në kreun I “Matura Shtetërore”, të udhëzimit nr. 32, datë 23.12.2022, “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2023”, ndryshon si më poshtë:

“15. Testi i provimit “Gjuhë dhe letërsi italiane” (*Lingua e literatura italiana*) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane përgatitet nga Ministria e Arsimit e Republikës së Italisë dhe dorëzohet në QSHA në afatin kohor të përcaktuar për këtë provim. Ky provim zhvillohet në datën 1 qershor 2023 dhe zëvendëson provimin e gjuhës së huaj (D3) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane. Në notën e provimit përfshihet, siç është parashikuar në Memorandum, edhe vlerësimi i zhvilluar në shkollë në datën 29 maj 2023, para një komisioni të ngritur nga palët.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi zëvendësministri i Arsimit dhe Sportit (MAS), zëvendësministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE), Sekretari i Përgjithshëm i MAS-it, Sekretari i Përgjithshëm i MFE-së, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat arsimore vendore parauniversitare, Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional në MFE, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

MINISTËR I FINANCave DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj